

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ Denoncimi i Ahmetajt/ Përgjimi i ri i Ron Yeffet: Mos dërgoni letra në Ministrinë e Energjetikës, për këtë merrem unë
ADRESA	https://albeu.com/lajme/denoncimi-i-ahmetajt-pergjimi-i-ri-i-ron-yeffet-mos-dergoni-letra-ne-ministrine-e-energjetikes-per-kete-merrem-une/1011620/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:45:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:40:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2fc8c20bb76a4ff0c811a0e3ceb40734c6dc98da148abc28ee200c746bc90365
TEKSTI	f7f46325f5418c9420fae2ed0a3874dad8aa6150e31947c86e02a2d32ebfcf6e
PAMJA	e19956c55bf9891d6338fa52c0663e28bd65d2124354882fdc73655bc1d1081a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1b8975980d77205e48435cbe72f0cfc9782e92a08ffe6e4f595eaf3db0165b1a
E MËPARSHMJA	0d4e609e6bd6309699e73c515a499946cb4f812dc16b1fe017f5c86a1d1d6f94
RRËNJA MERKLE	73f979cbb29df4dc252dd8de7b79776fe8a97b12508dad62bfe4a34c64a4bb40
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/1b8975980d77205e48435cbe72f0cfc9782e92a08ffe6e4f595eaf3db0165b1a

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

VIDEO/ Denoncimi i Ahmetajt/ Përgjimi i ri i Ron Yeffet: Mos dërgoni letra në Ministrinë e Energjetikës, për këtë merrem unë



Është bërë publik mbrëmjen e sotme një audiopërgjim ku dëgjohej Roni Yeffet në bisedë me tre shtetas të huaj: një ukrainas, një rus dhe Tatianën, e cila ka shërbyer si përkthyes gjatë komunikimit.

Materiali u transmetua në emisionin "Çim Peka Live", në Syri TV, dhe lidhet me pushtet dhe gazetë në Vlorë. Gjatë bisedës, Yeffet këmbëngul që marrëveshja të përmbyllet sa më shpejt, ndërsa i kërkon Tatianës të mos dërgojë asnjë shkresë zyrtare në Ministrinë e Energjetikës, duke thënë se do të merret vetë me këtë institucion.

Ky regjistrim është pjesë e një dosjeje që zgjat më shumë se 3 orë dhe është realizuar në Janar të vitit 2026. Në të, Roni Yeffet, i cilësuar si izraeliti i Edi Ramës, diskuton mënyrat se si mund të shiten pasuritë e Shqipërisë.

Transkriptimi i audiopërgjimit:

Tatiana: Do të përgatisim një letër zyrtare për Ministrinë e Energjetikës, në mënyrë që të marrim të dhëna për gazin në Vlorë. Një letër zyrtare.

të fundit/



Skandali "Kayo", Hoxhaj: Shteti dha 30 milionë euro për mjet...



Skocia, Uells dhe Irlanda e Veriut bashkohen në kërkes...



Audiopërgjimet e Ron Yeffet, Artan Hoxha: Balluku drejtoi...



Karamuço rrëfen arratisjen e Alket Rizait: E dinin në burg, por u...



Carragher: Arsenali është forcuar ndjeshëm pas transferimit të...



Inteligjenca artificiale transformon kardiologjinë: nga EK...



ASH zyrtarizon mbështetjen për kandidatin e AKI-së n...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Roni Yeffet: Përse? Përse? Jo, jo, nuk duhet asnjë letër zyrtare. Shkoni në Vlorë dhe shihni çfarë të dëshironi. Më pas do të merrem unë me ta. Mos dërgoni asnjë letër dhe asgjë tjetër. Informacioni është për ne, jo për Ministrinë.

Tatiana: Në rregull, por ajo që na tha ajo është shumë e rëndësishme. Vetëm një vizitë në terren nuk do të mjaftonte. Një inspektim fizik nuk do t'i jepte kompanisë mundësi të kuptonte asgjë.

Roni Yeffet: Për Ministrinë e Energjetikës mbështetuni te unë. Do të shkojmë atje dhe do të bisedojmë me ta për çdo çështje. Megjithatë, mos e përdorni emrin tim.

Tatiana: Dakord.

Roni Yeffet: Në Vlorë, dakord. Ju do të kryeni kontrollet, pasi përfaqësoni një kompani amerikane.

Tatiana: Dakord.

Roni Yeffet: Do të kontrolloni, do të bëni verifikimet dhe do të pyesni për gjithçka. Ata do të bashkëpunojnë. Thuaji asaj të vijë të hënën dhe të qëndrojë këtu. Do të shkoni në Ministrinë e Energjetikës 1, 2, 3 herë.

Tatiana: Mendoj se ajo do të mbërrijë të mërkurën.

Roni Yeffet: Nëse vjen të hënën dhe qëndron, është më mirë, sepse të mërkurën dhe të premten këtu nuk punon askush. Kjo nuk është efikase; duhet të jemi më efikasë.

Tatiana: Dakord, dakord.

Roni Yeffet: Nëse ajo vjen të mërkurën, ata do të vijnë të premten dhe nuk do të ndodhë asgjë. Ajo duhet të qëndrojë këtu derisa ta përfundojmë. Unë dua që ta mbyllim. Duhet ta kuptoni se kam nevojë të nisë puna; duhet të përfundojmë marrëveshjet.

Tatiana: Ajo vjen nga Johannesburgu dhe të hënën do të jetë këtu. Nga mëngjesi i së martës...

Roni Yeffet: Por ajo nuk duhet të largohet deri në fundjavë.

Tatiana: Dakord.

Shtuar më 14.09.2026 21:40

Tags: [-Politikë](#), [kryesore](#), [Lajmet e fundit](#), [Shqipëria](#), [Të Gjitha](#)



"Mos e përmendni emrin tim"/ Audiopërgjimi zbulon udhëzimet e Ron Yeffet:...



Mbyllen fjalimet para Kryeministrit, protestuesit marshojnë drejt Bllokut të...



Karburantet shtrenjtohen sërish, Shqipëria pa masa të reja fiskale dhe pa Akti...



Pas skandalit me abuzimet, ish-deputeti socialist Alban Xhelili emërohet drejtor i...



PD dënon kërcënimin ndaj Osman Stafës: Fjalën e lirë nuk mund ta mposhtë...



Kërcënimi me jetë i gazetarit Osman Stafa, reagon Policia e Shtetit



AGSH ankimon rregulloren e GJKO-së në Kushtetuese, Myzyraj dh...



Ilir Meta del nga kafazi/ Gjykata e Apelit pranon kërkesën e ish-presidenti...

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë